

## Vendim nr. 228 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marjana Semini, Anëtare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** EDUARD KELMENDI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1922(120), datë 27.03.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe nenet 1 të Protokollit nr.1 dhe 1 të Protokollit nr.12.1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është emëruar në detyrën e nënkryetarit të njësisë bashkiake nr. 10, Tiranë me urdhrin nr. 63, datë 03.08.2007 të kryetarit të asaj njësie. Pas zgjedhjeve vendore dhe riorganizimit të njësisë vendore, ai është larguar nga detyra me urdhrin nr. 11239, datë 21.08.2015 të kryetarit të Bashkisë Tiranë.

2. Duke mos qenë dakord me largimin nga detyra, kërkuesi, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës, ka ngritur padi në gjykatë me objekt shpërblimin e dëmit për shkak të mosrespektimit të procedurave dhe afatit të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkak të justifikuar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6161, datë 03.12.2015, ka vendosur pranimin e pjesës së padisë dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë ta shpërblejë kërkuesin, gjithsej, me 19 paga mujore.

3. Ndonëse Bashkia Tiranë ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 86 (93), datë 19.01.2018. Mbi bazën e rekursit të Bashkisë Tiranë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1082 (189), datë 13.05.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, si dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit.

4. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) me objekt shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të kontradiktoritetit dhe së drejtës për t'u dëgjuar, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Gjykata, me vendimin nr. 13, datë 21.03.2023 (*vendimi nr. 13/2023*), ka vendosur pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim pranë asaj gjykate, e cila ka vlerësuar se: (i) kërkuesit i ishte cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor i lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, si pjesë e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, pasi nuk i ishte dhënë mundësia të paraqiste paraprakisht mendimin e tij për çështjet ligjore të analizuar nga Gjykata e Lartë me nismën e saj, duke u vënë në pamundësi për t'u mbrojtur efektivisht për to dhe duke u përballur kështu me një vendim gjyqësor që nuk i jepte përgjigje përfundimtare pretendimeve të tij (*shih paragrafët 33 dhe 34 të vendimit nr. 13, datë 21.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*); (ii) ndërsa pretendimi për cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe së drejtës për t'u dëgjuar ishte haptazi i pabazuar (*shih paragrafët 21-26 po aty*); (iii) Gjykata e Lartë në rishqyrtimin e çështjes do të ushtronte funksionin e saj të kontrollit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta dhe do t'u jepte përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit të ngritura në rekurs, ndaj pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk merrej në shqyrtim prej saj (*shih paragrafin 35 po aty*).

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pas rishqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, me vendimin nr. 00-2024-1922 (120), datë 27.03.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, si dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit.

6. Në datën 29.07.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar paraprakisht shkaqet e rekursit dhe, për pasojë, ka shqyrtuar çështjen në tejkalim të juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj. Gjykata e Lartë duhet të kishte vendosur mospranimin e rekursit të Bashkisë Tiranë me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga ligji dhe se gjykatat e faktit u kishin dhënë përgjigje pretendimeve të Bashkisë Tiranë. Ajo gjykatë, në tejkalim të kompetencave të saj, ka nxjerrë si shkak për ndryshimin e vendimeve “funksionin politik” të kërkuesit, që as vetë Bashkia Tiranë nuk e kishte ngritur, duke mbrojtur kështu interesat e saj. Gjykata e Lartë ka vepruar si gjykatë fakti dhe e ka zgjidhur vetë çështjen në themel, në vend që ta kthente atë për rigjykim. Po kështu, ajo ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga praktika e saj e mëparshme për çështje të ngjashme, në të cilat ka vendosur mospranimin e rekursit.

7.2. *Fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrimet për standardin e arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive sipas vendimit nr. 13/2023 të Gjykatës. Gjykata e Lartë i ka njoftuar palët për datën dhe orën e seancës gjyqësore, por nuk e ka ftuar kërkuesin për të paraqitur paraprakisht mendimin e tij me shkrim. Ajo gjykatë nuk i ka dhënë kërkuesit përgjigje të arsyetuar për pretendimin se ishte cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj për shkak të qëndrimit të ndryshëm të saj të mëparshëm në çështje të ngjashme, siç i ishte lënë detyrë nga Gjykata.

7.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i njëjtë me vendimin e shfuqizuar, duke mos i dhënë një përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkuesit siç i ishte lënë detyrë nga Gjykata.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

9. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga kjo Gjykatë me vendimin nr. 13/2023. Në këto rrethana, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të tij përveç ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577/2000, pasi vendimi i kundërshtuar prej tij, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 27.03.2024, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 29.07.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se i është cenuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, se nuk është respektuar fuqia detyruese e vendimeve të Gjykatës dhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim. Duke mbajtur në konsideratë se argumentet e dy pretendimeve të fundit të kërkuesit janë të ndërlidhura ndërmjet tyre, ato do të trajtohen bashkërisht.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*

13. Kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në tejkalim të juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj. Sipas tij, ajo gjykatë ka vepruar si gjykatë fakti dhe e ka zgjidhur vetë çështjen në themel, ndërkohë që nuk duhej ta kishte kaluar çështjen në seancë gjyqësore, por duhej të kishte vlerësuar paraprakisht shkaqet e rekursit të Bashkisë Tiranë dhe të kishte konstatuar se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji, ndaj duhej të kishte vendosur mospranimin e tij. Po kështu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka analizuar konceptin e “funksionit politik”, që nuk ishte ngritur si shkak nga Bashkia Tiranë.

14. Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj” kërkon që gjykatat të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (shih vendimet nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Kolegji vëren se neni 473/a, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Civile (KPC) përcakton se kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Për këto raste, neni 482/a, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së parashikon se Gjykata e Lartë vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes. Ndërsa sipas nenit 63, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pas shqyrtimit të çështjes, vendos ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe zgjidh çështjen në themel kur zbatimi i ligjit procedural ose material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes.

16. Duke mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese dhe parashikimet ligjore të mësipërme, Kolegji vëren se gjatë rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, fillimisht ka verifikuar kushtet formale të rekursit dhe ka vlerësuar se rekursi ishte i pranueshëm për shqyrtim, pasi ishte ushtruar në afat, në përputhje me parashikimet ligjore, nga një subjekt i legjitimuar për ushtrimin e tij dhe se përmbante shkaqe që lidheshin me zbatimin e ligjit material nga gjykatat e faktit. Në këtë fazë, ajo ka vepruar brenda kompetencave të veta të përcaktuara nga ligji dhe në përputhje me standardet kushtetuese, sipas të cilave, Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe

vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Si për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri seleksionues të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 15, datë 21.03.2014; nr. 22, datë 20.05.2013; nr. 19, datë 25.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në vijim, Gjykata e Lartë, duke mbajtur në konsideratë problematikën dhe kompleksitetin e çështjes, si dhe faktin se çështja ishte kthyer për rishqyrtim nga Gjykata, ka vendosur ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, të cilave u është dhënë mundësia të shprehin mendimin e tyre për çështjen e ligjit të zbatueshëm, të marrë në shqyrtim kryesisht nga ajo gjykatë. Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka vlerësuar se vendimet e gjykatave të faktit duheshin ndryshuar, në kushtet kur zbatimi i ligjit material për rastin në shqyrtim, nuk diktohej nga nevoja për rivlerësimin e fakteve ose provave dhe e ka zgjidhur përfundimisht vetë themelin e mosmarrëveshjes, pasi marrëdhënia e punës së kërkuesit, i cili ishte funksionar politik, rregullohej nga një ligj i posaçëm dhe jo nga Kodi i Punës, siç kishin vlerësuar gjykatat e faktit.

18. Në analizë të këtij qëndrimi, Kolegji çmon se Gjykata e Lartë ka ushtruar kompetencat e saj në përputhje me ligjin dhe standardet kushtetuese, sipas të cilave ajo mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta (*shih vendimet nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 10, datë 03.04.2018; nr. 20, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa më sipër, Kolegji çmon se Gjykata e Lartë, duke e kaluar çështjen në seancë gjyqësore për të identifikuar dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm, si dhe zgjidhur përfundimisht themelin e mosmarrëveshjes, ka vepruar brenda kompetencave të saj, duke respektuar procedurat ligjore, ndaj pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, është haptazi i pabazuar.

*C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës*

20. Kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë, në rishqyrtimin e çështjes së urdhëruar nga Gjykata, nuk ka riparuar cenimin e të drejtave kushtetuese të tij dhe ka dhënë në themel të njëjtën zgjidhje me atë të shfuqizuar. Sipas tij, edhe pse Gjykata e Lartë i ka njoftuar palët për

shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, ajo nuk e ka ftuar kërkuesin për të paraqitur paraprakisht mendimin e tij me shkrim lidhur me çështjen e ligjit të ngritur kryesisht nga ajo gjykatë. Gjithashtu, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë kërkuesit përgjigje të arsyetuar për pretendimin se ishte cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj për shkak të qëndrimit të ndryshëm të saj të mëparshëm në çështje të ngjashme, siç i ishte lënë detyrë nga Gjykata.

21. Gjykata në jurisprudencë të vazhdueshme ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i takon fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se ajo gjen shprehje të qartë në nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës. Vendimet e Gjykatës kanë forcë detyruese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 55, datë 10.07.2024; nr. 66 datë 06.12.2023; nr. 49, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Kolegji do të verifikojë nëse në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë ka riparuar cenimin e së drejtës kushtetuese të kërkuesit, që ishte shkaku i shfuqizimit të vendimit nga Gjykata, si dhe nëse vendimi i Gjykatës së Lartë është i arsyetuar, pa gabime ligjore ose faktike të dukshme, pra nëse interpretimi i ligjit prej saj ka qenë haptazi i paarsyeshëm.

24. Kolegji vëren se në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar, Gjykata e Lartë ka evidentuar standardin kushtetues lidhur me marrjen e mendimit të palëve, kur gjatë shqyrtimit të rekursin vihen në diskutim çështje të ligjit, të ngritura kryesisht dhe për të cilat palët nuk janë shprehur më parë. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se mosrespektimi i këtij standardi ishte shkaku që Gjykata me vendimin nr. 13/2023 kishte shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë dhe kishte urdhëruar rishqyrtimin e çështjes, ndaj për këtë arsye ajo kishte vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, me pjesëmarrjen e palëve dhe se kërkuesi

kishte marrë pjesë rregullisht në gjykim (*shih paragrafët 21-22 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, atij i është dhënë mundësia të japë mendim për çështjen e ligjit të zbatueshëm në çështjen e tij, ndaj Gjykata e Lartë ka respektuar forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës.

25. Për sa i takon argumentit të kërkuesit për zgjidhjen e themelit të çështjes në mënyrë të njëjtë me vendimin e shfuqizuar, Kolegji vëren se, në thelb, ai ka natyrë ligjore dhe ka të bëjë me zbatimin e ligjit, i cili, si rregull, është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, dhe nuk mund të bëhet objekt i kontrollit kushtetues (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë pikë, Kolegji vë në dukje se shkak i shfuqizimit të vendimit të Gjykatës së Lartë nga Gjykata lidhej me të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit për çështjet ligjore të ngritura kryesisht, që siç u theksua më lart, është riparuar nga Gjykata e Lartë në rishqyrtimin e çështjes. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

26. Në lidhje me argumentin se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar detyrën e lënë nga Gjykata për t'i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit se në çështje të ngjashme ajo ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me ligjin material, Kolegji vë në dukje se interpretimi i ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Lartë në çështjen e kërkuesit nuk rezulton të ketë qenë arbitrar dhe në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e tij, pasi çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës, është haptazi i pabazuar.

28. Si përfundim, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara, për pasojë kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.